

Nr. 1214-prost
Dt: 11-05-2023

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHËSHME TË SHOQËRISË
UK-CERRIK SHA

NR. 08. DATË 11 / 05 / 2023

Sot, më datë 11 Maj 2023, Shoqëria UK-Cerrik, një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, me kodin unik NIPT L63502206Q mbajti mbledhjen e Asamblesë. Mbledhja u thirr nga administratori i shoqërisë zoti Eneo Taça, për të diskutuar mbi rendin e ditës si vijon:

Çështjet e rendit të ditës:

- Prishja e shoqërisë dhe shpallja e saj në likuidim;
- Shkarkimin e Administratorit
- Emërimi i Likuidatorit.

Në shqyrtim të rendit të ditës, Asambleja vëren:

Shoqëria UK-Cerrik nuk zhvillon më aktivitete pasi në përputhje me VKM Nr. 302, datë 11.05.2022 si dhe me marrëveshjen noteriale Nr. 4306 Rep. dhe Nr. 2330 Kol, datë 12.10.2022 midis shoqërisë UK-Cerrik dhe shoqërisë Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sha, kjo shoqëri e ka transferuar veprimtarinë ekonomike si dhe aktivet dhe detyrimet e saj në tërësi. Nga data 1.1.2023, kjo shoqëri nuk ka më të drejtë të zhvillojë aktivitetin për të cilin ajo është themeluar.

Për sa konstatohet më sipër, shoqëria e ka përmbushur qëllimin e krijimit dhe nuk ka më arsye të vijoje ekzistencën e saj dhe duhet të priset dhe të cregjistrohet nga regjistri tregtar QKB.

Pasi diskutoi gjerësisht mbi rendin e ditës, Asambleja vendosi:

- (1) Përfundimin e aktivitetit të shoqërisë dhe prishjen e saj
- (2) Shoqëria shpall hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese;
- (3) Shkarkimin e Z. Eneo Taça si Administrator të shoqërisë U-K Cerrik sha.
- (4) Emërimin e Znj. Iva Zeneli si likuidator të shoqërisë
- (5) Likuidatori është i autorizuar të përgatisë Raportin Përfundimtar të likuidimit të shoqërisë. Ai është gjithashtu i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për likuidimin e shoqërisë si dhe të kërkojë, paraqesë çdo dokument të nevojshëm pranë autoriteteve private dhe publike në lidhje me likuidimin e shoqërisë.

Pasi u siguria se nuk ka më çështje për diskutim, mbledhja mbyllet dhe vendimi nënshkruhet në 3 kopje identike si vijon:

ASAMBLEJA E AKSIONARËVE

KRYETAR

Andis SAHA

